


EDITORIAL

Lamtumirë MuSPP1, Mirë se vjen MuSPP2



Më 2 Qershor në hotelin Grand u mbajt takimi i katërt dhe i fundit i Grupit për Shqyrtimin Trepalësh (TPR). Takimet e TPR-së i bashkojnë sponsoruesin e programit (Sida), zbatuesin e programit (UN-HABITAT) dhe homologët e tij (komunat përfituese dhe institucionet qendrore, duke përfshirë këtu edhe Asociacionin e Komunave të Kosovës -AKK). Qëllimi i këtyre takimeve është monitorimi dhe vlerësimi i të arriturave dhe metodave të punës së Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor në Komuna (MuSPP).


Më 2 Qershor u prezantuan dhe u diskutuan "Pikat më kryesore të MuSPP1 2006-2008", duke përfshirë edhe disa vështirësi që ishin hasur në fazën e parë (shih kutinë 1, fq 10). Për shqyrtimin e këtyre të arriturave dhe vështirësive ishin zhvilluar edhe diskutime të tjera më herët gjatë takimit të Selanikut me kryetarët e komunave që janë përfituese nga MuSPP-ja dhe me ministrinë e nivelit qendror (Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-MMPH dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal-MAPL), mbajtur prej 26 deri më 29 maj.

Kryetarët e pranuan se kapacitetet planifikuese të komunave janë ende shumë të dobëta për t'u marrë me sfidat e mëdha të urbanizimit dhe zhvillimit të shpejtë dhe të pakontrolluar. Por ata shprehën zotimin e tyre të fuqishëm për angazhimin e tyre të drejtpërdrejt personal në procesin e planifikimeve komunale. Për të ndihmuar në këtë, kryetarët e komunave kërkuar më shumë bashkëpunim në mes tyre dhe MuSPP2, përmes ofrimit të këshillave strategjike për menaxhimin urban, përfshirë edhe planifikimin shumë-sektoral dhe menaxhimin e projekteve.

Një temë tjetër që u diskutua në takimin e Selanikut ishte edhe

nevoja për riorganizimin dhe ringjalljen e strukturave dhe organeve ekzistuese për planifikim nëpër komuna, në mënyrë që më vonë këto t'u përgjigjen më mirë sfidave në zhvillimin urban dhe rural. Këshilla e MuSPP-it për forcimin e rolit të ekipit komunal të planifikimit, i cili përbëhet nga shumë drejtori, njësisë së planifikimit, këshillit të ekspertëve planifikues dhe në fund, por jo më pak e rëndësishme, për njohjen e këshillit joformal të organizatave të shoqërisë civile, u mirëprit nga të gjithë kryetarët e komunave dhe ministrat ose të deleguarit e tyre që morën pjesë në takim. Po ashtu u shpreh mbështetje e fuqishme edhe për mundësinë dhe nevojën për bashkëpunimin ndërkomunal, rajonal dhe ndërkufitar. Të gjitha këto elemente u pasqyruan në Dokumentin e programit për MuSPP2, ashtu siç u prezantuan në Selanik dhe u konfirmuan sërish në TPR-in e mbajtur në Hotelin Grand (shih kutinë 2, fq 10).

Dita e 2 Qershorit shënoi përfundimin zyrtar të MuSPP1 dhe tranzicionin e lehtë në MuSPP2, i cili do të zhvillohet deri në vitin 2011. Faza e tranzicionit do të përfundojë me nënshkrimin përfundimtar të Memorandumeve të Mirëkuptimit (MM) ndërmjet UN-HABITAT-it dhe komunave përfituese. Këto memorandume të mirëkuptimit do të përbëhen nga një pjesë e përgjithshme, e cila vlen për të



gjithë partnerët, dhe një pjesë specifike më udhëzime konkrete për secilën komunë. MM-të kanë për qëllim që të qartësojnë rolet dhe përgjegjësitë e partnerëve në mënyrë që të arrihet një bashkëpunim sa më i mirë dhe më efikas.

(vazhdon në faqen 10)

TRANSPORTI JO I MOTORIZUAR

"Nga dielli dhe nga era, të punojmë së bashku dhe të studiojmë burimet alternative të energjisë që mund të shfrytëzohen për të plotësuar nevojat tona. Dhe të shohim nëse mund ta bëjmë Kosovën vendin më të gjelbër në Evropën Juglindore." Hashim Thaçi, Kryeministër i Kosovës në raportin Energjia për zhvillim, të publikuar nga UNDP në maj 2008.

Sipas këtij raporti, transporti i motorizuar në Kosovë konsumon sasi të naftës që është ekuivalente me 414,80 Kilo ton naftë (ktoe) ose 8,3 Mega xhul (MJ) /për banorë/në vit. Kjo paraqet 1/3 e konsumit të përgjithshëm të energjisë në Kosovë. Ky përpjesëtim është i njëjtë me konsumin global të energjisë, si për shembull, në Zvicër, ku konsumi i përgjithshëm i energjisë është pesë herë më i lartë. Transporti, si në çdo vend tjetër të Evropës, konsumon një pjesë të madhe të energjisë së përgjithshme, por sistemi i mobilitetit në Kosovë vërtetë e shfrytëzon energjinë në mënyrë mjaft efikase. Ekzistojnë shumë faktorë që i kontribuojnë kësaj: kosovarët udhëtojnë relativisht pak dhe kryesisht bëjnë udhëtime të shkurtra. Ata kryesisht ecin në këmbë dhe për këto udhëtime ata shfrytëzojnë transportin publik. Edhe automobilat përdoren në mënyrë të përgjegjshme, me një automobil voziten më shumë njerëz dhe shpejtësia e vozitjes është mesatare.

Me zhvillimin ekonomik, kosovarëve do tu duhet dhe do të dëshirojnë të udhëtojnë më shumë dhe më shpejt. Nëse transporti jo i motorizuar dhe transporti publik mund të mbajnë, apo edhe të rrisin pjesëmarrjen e tyre në transportin e përgjithshëm, kostoja që lidhet me qarkullimin e shtuar të automobilave (konsumimi i energjisë, aksidentet dhe ndotja, infrastruktura) mund të kufizohen dhe resurset e kursyera mund të investohen në sektorët e prodhimit (industri, biznes, arsim, shëndetësi). Se a do të mund të zhvillohet mobiliteti i kosovarëve në mënyrë që të shfrytëzohet më mirë energjia dhe që ajo të ketë kosto të përballueshme, varet shumë nga planifikimi hapësinor dhe ai urban.

Vendbanimet e dendura më funksione të përziera kërkojnë udhëtime të shkurtra nga shtëpia në punë, për të blerë gjërat e nevojshme dhe për aktivitete të kohës së lirë, të cilat mund të bëhen shpejt dhe lehtë duke ecur në këmbë ose me biçikletë, me karrocë ose me ndonjë mekanizëm tjetër. Ato po ashtu bëjnë të mundur organizimin më efikas të transportit publik ndërmjet tyre. Ndërsa vendbanimet me dendësi të vogël dhe mono-funksionale krijojnë nevojën për udhëtime të gjata të cilat është më



vështirë që të mbulohen me mënyrat e transportit që shpenzojnë më pak energji dhe që kanë kosto më të lirë. Qytetet e Kosovës janë duke u rritur me shpejtësi dhe në mënyrë relativisht të dendur. Kjo është një gjë e mirë për të ardhmen e energjisë në këtë vend. Planifikimi hapësinor duhet të përmirësojë urbanizimin e dendur dhe t'u ofrojë qyteteve që po rriten një infrastrukturë adekuate për lëvizje jo të motorizuar dhe për transport publik.

Qytetet e dendura që shfrytëzojnë transportin jo të motorizuar dhe transportin publik planifikohen në mënyrë të veçantë. Rrugët dhe vendet ndërtohen për të jetuar, punuar, shitur dhe blerë, luajtur dhe për të lëvizur në këmbë ose me biçikletë. Varësisht prej situatës, kjo përkthehet në rrugë me trotuare dhe me zona me qarkullim të qetë ku automobilat lejohen vetëm në mjediset jo të motorizuara. Vendet pa qarkullim të automjeteve dhe rrugët që i bien shkurt për transportin jo të motorizuar përmes blloqeve të objekteve të banimit, shtigjet për këmbësorë në mes të ngastrave të tokës, kalimet, shtigjet pranë lumenjve, etj, janë elementet thelbësore të një sistemi të transportit urban. Qytetet e Kosovës kanë plot karakteristika të këtilla. Megjithatë, në shumë raste, ato kanë humbur për shkak të mosmirëmbajtjes ose për shkak të uzurpi

mit të tyre për nevoja private.

Shumë lagje që janë përmirësuar përmes qasjes me pjesëmarrje, po ashtu ofrojnë kushte të shkëlqyeshme për mobilitetin jo të motorizuar. MuSPP-ja është duke mbështetur disa projekte në këtë fushë: qendrën e mobilitetit në Ferizaj, infrastrukturën rrugore në Mitrovicë (Jug dhe Veri), rrjetin CityBus (autobusi i qytetit) në Pejë (me infrastrukturën tjetër për këmbësorë), hapësirat e gjelbra në Gjakovë, ambientet e sigurt shkollorë në Gjiilan dhe Prizren, etj. Këta janë hapat e parë drejt master planeve dhe planeve të veprimit për mobilitet plotësisht jo të motorizuar, të cilat janë komponente të nevojshme të planeve për urbanizim të qëndrueshëm, për zhvillim ekonomik dhe për përdorim efikas të energjisë dhe resurseve financiare.

Kosova ka shembuj të shkëlqyeshëm të praktikave të mira për struktura dhe dizajn urban; Sheshi Nëna Terezë në Prishtinë është shembulli më i spikatur. Por veçanërisht qytetet mesatare në Kosovë që marrin pjesë në MuSPP kanë mundësi për tu bërë qytete "të gjelbra dhe vitale" (motoja e Pejës), e që do ta bënin Kosovën rast referimi të mobilitetit të qëndrueshëm.

Joachim Bergerhoff

Ekspert i MuSPP-it për Mobilitet

MANIFESTIMI ÇIKLISTIK NË PEJË NË DITËN E EVROPËS

Nuk është mes atyre dhe neve, por është në mes teje dhe meje



Me 3 maj 2008 në Pejë u shënuar Dita e Evropës me një aktivitet të kombinuar çiklistik, nën moton "Nuk është mes nesh dhe atyre, është mes teje dhe meje".

Ky manifestim u organizua bashkërisht nga MuSPP/UN-HABITAT, ECLLO (Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian), Komuna e Pejës, klubi çiklistik "Peja" nga Peja dhe SSF (Sports Sans Frontiers) dhe ndahej në dy pjesë:

Pjesa e parë ishte dedikuar promovimit të ngasjes së biçikletës në qytet, si një mjet shumë efikas i transportit, veçanërisht për një qytet si Peja. Kjo ishte një mundësi e mirë për të paraqitur ambicinet e programit MuSPP (shih artikullin në fq 2) dhe për të demonstruar më mirë rrjetin për biçikleta në qytet, si pjesë të politikave komunale për

mobilitet. Ajo po ashtu demonstroi idenë e Javës së Evropës për çiklizmin si një mjet për përfshirjen dhe kohezionin social.

Në ditën e parë, pjesëmarrësit bënë një xhiro me biçikleta nëpër qytet në një grup të udhëhequr nga kryetari i komunës së Pejës z. Ali Berisha dhe Shefi i ECLLO z. Renzo Davidi. Kjo xhiro ishte rreth 8 km e gjatë, me një ndalesë të stacioni i trenit.

Arsyeja e ndalesës ishte që t'i dëshirohet mirëseardhje një grupi tjetër të çiklistëve që ishte nisur më herët nga Istogu dhe Klina. Të dy këto grupe u bashkuan në një grup më të madh (me rreth 120 pjesëmarrës) dhe vazhduan xhiron deri në qendër të qytetit.

Kjo xhiro me biçikleta u dukej qytetarëve

shumë interesante dhe ata e përshëndetnin grupin. Pjesa e dytë e këtij manifestimi ishte një garë ndërmjet ekipeve çiklistike të shkollave fillore, me pjesëmarrjen e rreth 30 personave.

Tre çiklistëve të parë iu nda nga një shpërblim financiar nga UN-HABITAT-i. Fituesi i vendit të parë mori një biçikletë, vendit të dytë iu ndanë një palë rroba sportive ndërsa vendit të tretë një palë mbathje sportive. Shpërblimet u ndanë nga kryetari i Komunës, z. Ali Berisha, z. Renzo Davidi dhe z. Joachim Bergerhoff nga MuSPP/UN-HABITAT-i.

Pas ceremonisë së ndarjes së shpërblimeve, manifestimi përfundoi dhe qendra e qytetit u hap sërish për qarkullim të automjeteve. Gjatë manifestimit Shërbimi Policor i Kosovës ofrojë një mbështetje të shkëlqyeshme duke shoqëruar grupin gjatë tërë kohës dhe duke rregulluar trafikun gjatë xhiros me biçikleta nëpër qytet.

Një falenderim i shkon edhe ndërmarrjes lokale private për prodhimin e lëngjeve "Bibita", e cila u ofroi pjesëmarrësve pije pa pagesë si në pikën pushimit në Vitomiricë ashtu edhe në ahengun e organizuar në qendër të qytetit.

Ngasja e biçikletës është duke u bërë gjithnjë e më e popullarizuar në Pejë. Vetëm pak ditë para xhiros me biçikleta në qytet, Klubi i çiklistëve të Pejës, Komuna dhe UN-HABITAT-i së bashku, mbajtën garën e parë të organizuar ndonjëherë në Kosovë të çiklizmit në bjeshkë. Kjo u zhvillua në një mal në veri të qytetit. Rreth 70 garues që përfaqësonin shkollat fillore nga Peja provuan për herë të parë kënaqësinë e ngasjes së biçikletave në natyrë, në një shteg mjaft të mundimshëm rreth 800 metra të gjatë.

Duke ditur se me 16 prill është zhvilluar punëtorja për planifikimin e transportit jo të motorizuar, ne mund të përfundojmë se çiklizmi në Pejë e ka një të ardhme të ndritur. Falenderimet janë edhe për z. Modest Gashi, si dhe kryetarin e Klubit çiklistik "Peja", z. Agim Mala, për punën e tyre në organizimin e këtij manifestimi.

Agron Sallova dhe Shkëlqim Daci

Ekipi i MuSPP-it në Pejë

PLANIFIKIMI URBAN - NJË SINTEZË E PRODUKTEVE DHE PROCESIVE

Qytetet dhe vendet vazhdimisht ndryshojnë, nganjëherë në mënyrë të paparashikueshme. Si do të jetojmë, si do të punojmë, si do të bëjmë biznes apo si do të argëtohem në kohën e lirë pas 10-20 ose më shumë vitesh? Nuk e dimë, por kjo nuk do të thotë se nuk duhet të planifikojmë dhe të projektojmë për të ardhmen. Derisa mendojmë për të ardhmen, ne duhet të kuptojmë të kaluarën dhe të tashmen.

Interesave të kujt u shërbejnë planifikuesit urban?

I gjithë zhvillimi urban synon që të ndikojë tek njerëzit e ndryshëm në mënyra të ndryshme, ku zhvillimi udhëhiqet nga dhe u përgjigjet interesave publike. Ne duhet të dimë më shumë për njerëzit për të cilët planifikojmë dhe dizajnojmë: si jetojnë ata, si punojnë, si lëvizin dhe cili është vizioni i tyre për të ardhmen e vendit të tyre?

Një shembull i mirë i të menduarit për in-

teresin e përgjithshëm publik është shndërrimi i hapësirave publike në vende publike përmes një dizajni urban që është si sintezë e produkteve dhe proceseve. Kjo qasje u prezantua nga Jenny Donovan, eksperte e MuSPP-it për dizajn urban dhe hapësira publike, në një punëtori të organizuar nga MuSPP-I në Gjakovë. Punëtorja mbledhi një numër të madh të palëve të ndryshme me interes, përfshirë edhe profesionistët dhe punonjësit e komunës, shoqërinë civile, OJQ-të përkatëse, nxënësit e shkollave të mesme, etj.

Dizajni i konceptit për parkun qendror të qytetit në Gjakovë u elaborua sipas propozimeve të bëra, arsyeve dhe argumenteve për nevojën për një qasje serioze për trajtimin, formësimin dhe zbatimin e mikroelementeve urbane në hapësirat publike përmes dizajnit të përshtatshëm urban, i cili është dhe duhet të jetë në të mirë të të gjithë qytetarëve.

Duke njohur mirë karakteristikat fizike të një

vendi, mjedisin e tij dhe kushtet ekologjike, kushtet lokale ekonomike dhe shoqërore, ne mund të krijojmë hapësira publike nga të cilat përfitojnë qytetarët jo vetëm sot, por edhe gjeneratat e ardhshme të cilat do të jenë krenare për vendimet që kemi marrë ne. Përmes një diskutimi emocional, të shëndoshë dhe aktiv me pjesëmarrësit rreth dizajnit urban si sintezë e produkteve dhe proceseve dhe porosia që u nxor nga kjo punëtori ishte:

- Puna jonë dhe vendimet tona duhet të jenë trashëgimi për të ardhmen.
- Ne duhet të jemi pjesë e procesit i cili formon botën përreth nesh.
- Ky aktivitet është i ri dhe është duke u zhvilluar nën moton "dizajnet e mira urbane janë nevojë në rritje" për zhvillimin e ardhshëm urban.

Ark. Elida Bejtullahu

Udhëheqëse e sektorit urbanistik,

Komuna e Gjakovës

ÇIKLIZMI ËSHTË ARGËTIM DHE BIÇIKLETA SI MJET DITOR I TRANSPORTIT MUND TË JETË MË ARGËTUESE SE SA QË BESOJNË NJERËZIT

Më 15 prill UN-HABITAT/ MuSPP-ja organizoi një punëtori për transportin jo të motorizuar për ekspertët e trafikut, planerët, zyrtarët komunalë dhe për qytetarët e Gjilanit, Mitrovicës dhe Ferizajt. Kjo punëtori, pjesë e një serie të punëtorive për çështjet e transportit (pas kategorizimit të rrugëve, transportit publik dhe planifikimit të rrugëve publike), i trajtoi konceptet themelore të planifikimit, dizajnit dhe promovimit të mobilitetit të qëndrueshëm.

Z. Jürgen Heyen-Perschon, drejtor i Institutit për politikën e transportit dhe zhvillimit (ITDP Europe) ishte ftuar në këtë ngjarje që të prezantojë shembujt e suksesshëm të promovimit të ecjes në këmbë dhe ngasjes së biçikletës në mbarë botën. Disa shembuj të shkëlqyeshëm nga Amerika Jugore (Bogota në Kolumbi dhe Curitiba në Brazil) tregojnë se është e mundur të ndryshohet qëndrimi dhe sjellja për mobilitetin e qëndrueshëm nëse vendimmarrësit janë të përkushtuar që të përmirësojnë cilësinë e jetës urbane. Ngasja e biçikletës dhe ecja në këmbë, të integruara në një sistem gjithëpërfshirës të transportit publik, janë mënyrat më të përshtatshme të transportit urban, kur është fjala për zvogëlimin e emetimit të CO₂, parandalimin e ndryshimeve klimatike dhe për

rritjen e sigurisë në trafik. Një analizë SWOT e strukturës ekzistuese urbane për komunën e Gjilanit tregon se vet qyteti ka potencial të madh të promovojë ngasjen e biçikletës dhe ecjen në këmbë:

- Zona urbane është ende kompakte, gjë që i bën udhëtimet të jenë të shkurtëra dhe të përshtatshme për biçikleta dhe për ecje në këmbë;
- "Celulat" e izoluar dhe të përcaktuara mirë të lagjeve të banimit janë të lidhura me një rrjet të rrugëve urbane në formë të rrezeve të orientuara drejt qendrës;
- Përdorimi i automobilave është ende i vogël (vlerësohet se mbi 70% të udhëtimeve urbane bëhen në këmbë, e pak prej tyre edhe me biçikleta).

Ndërsa, në rrugët kryesore dominojnë automobilat gjë që e pengon mobilitetin e këmbësorëve dhe çiklistëve. Disa masa të thjeshta mund të përmirësojnë kushtet e transportit jo të motorizuar, si optimizimi "inteligjent" i qarkullimit rrugor të lidhur me parkimin e automjeteve që është në dispozicion, duke shmangur trafikun përmes zonave të banuara dhe duke zbatuar politikën e parkimit. Çdo vit, lokali "Hani bar" organizon një manifestim argëtues çiklistik në Podgragje në luginën e Moravës. Çdo vit numri i pjesëmarrësve



shtohet. Kjo tregon se çiklizmi është argëtues dhe se biçikleta si mjet i përditshëm i transportit mund të jetë më argëtuese se që besojnë qytetarët.

Atëherë, le të shkojmë përpara!

Huig Deneef

Këshilltar i MuSPP-it Gjilan

NË PRIZREN U INAGURUA DEMO PROJEKTI PËR AMBIENT MË TË SIGURT SHKOLLOR

Projekti demonstrues për ndërtimin e murit të shkollës (rrethojës) në shkollën "Lidhja e Prizrenit", bashkëfinancuar nga Komuna e Prizrenit dhe MuSPP/UN-HABITAT-i, u inagurua më 11 Qershor 2008. Ceremonia e inagurimit është pasuar nga disa aktivitete sportive dhe nga një ekspozitë që ka mbledhur shumë nxënës dhe qytetarë të Prizrenit. Qëllimi i këtij projekti ka qenë rritja e sigurisë dhe inkurajimi i aktiviteteve sportive të nxënësve. Për këtë arsye procesi i zbatimit të projektit ishte paraparë me një mori aktiviteteve dhe kishte për qëllim angazhimin e pjesëmarrësve të ndryshëm që nga fillimi i projektit.

Një nga këto aktivitete ka qenë edhe debati në tryezë të rrumbullakët për ambientin e sigurt shkollor dhe sigurinë në përgjithësi, gjë që ka mbledhur nxënës, prindërit dhe mësuesit. Ideja pas këtij projekti ka qenë rritja e sigurisë së nxënësve gjatë aktiviteteve jashtë objektit në oborrin e shkollës dhe rrethit të saj më të afërt. Ideja tjetër ka qenë gjetja e një formule të pranueshme për të bërë këtë fushë të hapur për publikun e gjerë edhe pas aktiviteteve shkollore. Rezultati i këtij projekti nuk ka qenë vetëm

Pasqyrime nga Debati i Tryezës së Rrumbullakët

Më 18 mars 2008, UN-HABITAT-i në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit kanë organizuar tryezën e rrumbullakët me temën: "Për një mjedis më të sigurt shkollor", që kishte të bëjë me projektin demonstrues për ndërtimin e një muri të shkollës (rrethojës) në shkollën fillore "Lidhja e Prizrenit" në Prizren. Si pjesëmarrës në atë debat, por njëkohësisht edhe si drejtor i shkollës, unë kam qenë i ftuar për të shprehur mendimet e mia. Ky projekt i cili u prezantua gjatë debatit ka qenë një projekt i mirë dhe ka treguar një përkrahje të madhe nga UN-HABITAT-i për krijimin e një ambienti më të mirë e të sigurt shkollor në Kosovë, e në Prizren në veçanti. Si drejtor i shkollës jam gjetur para dilemave në lidhje me projektin. Nga Ztr. Ylber Gashi, arkitekt, përfaqësuesi i Drejtoratit të Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, sipas rregullave urbanistike, trotuari nuk guxon

rindërtimi fizik i murit të shkollës (rrethojës) dhe krijimi i një ambienti më të sigurt shkollor por edhe sensi më i madh i pronësisë së këtij projekti nga ana e të gjithë

të jetë më pak se 3 m. Nga njëra anë, ndërtimi i murit të shkollës (rrethojës) do të rriste sigurinë e nxënësve si dhe të këmbësorëve që kalojnë afër shkollës. Projekti gjithashtu do të kontribuonte edhe estetikës së zonës. Nga ana tjetër, muri i shkollës do të zvogëlonte hapësirën e fushës së lojërave, që shfrytëzohet për aktivitetet e jashtme sportive dhe lojëra. Shkolla dhe rrethoja origjinale me mur e oborrit të shkollës janë pjesë e trashëgimisë urbane dhe janë vendosur në programin për mbrojtjen e monumenteve kulturore dhe historike. Prandaj ato kërkojnë një trajtim të kujdesshëm për ruajtjen e karakterit të tyre historik. Shpresoj se shqetësimi im do të mirret parasysht gjatë implementimit të projektit dhe do të gjindet baraspesha mes vlerës historike dhe sigurisë së nxënësve.

Përmbledhja e artikullit shkruar nga:
Islam Bajrami
Drejtor i shkollës fillore "Lidhja e Prizrenit"

pjesëmarrësve, që kanë marrë pjesë në diskutimet dhe implementimin e këtij projekti.

NEVOJA PËR INTERVENIME NË HAPËSIRAT PUBLIKE



Planerët në komunën e Mitrovicës duhet të merren me shumë sfida gjatë punës së tyre ditore. Situata specifike me të cilën qyteti është ballafaquar gjatë 8 viteve të kaluara dhe mënyrën se si është zhvilluar qyteti, nuk garanton një mjedis të mirë të jetesës për shumicën e banorëve të saj. Nevoja për intervenime është e madhe dhe e shumëllojshme si në shtrirjen ashtu edhe në natyrën e saj, duke filluar nga infrastruktura teknike, shërbimet publike dhe pajisjet e deri te hapësirat publike, parqet dhe fushat e rekreacionit. Gjatë punëtorisë së dizajnit urban të organizuar nga UN-HABITAT-i dhe të ndihmuar nga një ekspert i dizajnit të hapësirës urbane vizitua 6 lokacione, ku secili ishte i ndryshëm

në pikëpamje të funksionit dhe strukturës urbane. Këto ishin: një park i vogël por me një lokacion strategjik; një park xhamie në qendër të qytetit, afër rrugës qarkore qendrore; dy vendbanime joformale afër bregut të lumit; oborri i muzeut në aksin kryesor të qytetit; oborri i blloqeve të banesave; dhe parku i Solanës që gjendet në qendër të një sistemi të zgjeruar kryqëzimi të rrugëve si një hyrje e rëndësishme e qytetit.

Në secilin lokacion është bërë një ushtrim i shkurtër, që ka demonstruar statet të cilat duhet të zhvillohen nga procesi i dizajnit. Kjo ka përfshirë edhe identifikimin e çështjeve lidhur me lokacionin, të kuptuarit e mënyrës

se si ky lokacion shfrytëzohet nga njerëzit, shpresat dhe shqetësimet e tyre; përgatitja e agjendës së dizajnit, identifikimi i çështjeve që duhet adresuar duke konsideruar një kontekst më të gjerë të planifikimit; përgatitja e propozimeve/drafteve të mundshme të dizajnit dhe zhvillimi i një strategjie për zbatim dhe mirëmbajtje duke përfshirë komunitetin.

Pas vizitave të bëra në këto lokacione, punëtorja ka vazhduar punën në zyrën komunale, ku është diskutuar detajisht lokacioni i parkut të xhamisë. Koncepti preliminar, i cili ishte pregaditur nga zyrtarët komunal, është kontrolluar në kuptim të parimeve të përmendura më lart, duke definuar objektivat kryesore dhe shqyrtimin e ideve të ndryshme të dizajnit. Përfundimisht diskutimi rezultoi me një propozim për intervenime të koordinuara që mund të arrihen duke adresuar çështjet në mënyrën më të mirë. Grupi i 5 zyrtarëve komunal, që kanë marrë pjesë në këtë punëtorje, kanë mirëpritur këtë iniciativë dhe kanë kuptuar që ka qenë një përvojë e dobishme për punën e tyre në të ardhmen.

Shyhyrete Peci,

Sektor i Planifikimit në Drejtorinë e Planifikimit, Urbanizmit, Rindërtimit dhe Banimit në KK të Mitrovicës

KONKURSI NDËRKOMBËTAR PËR ZGJIDHJEN IDEORE TË QENDRËS SË MOBILITETIT NË FERIZAJ



Dilemat që kërkojnë zgjidhje

Hekurudha, ajo që dikur ka qenë zemra e qytetit të Ferizajit, tani është një nga bregat dh dilemat më të mëdha të qytetarëve të Ferizajit. Çka të bëhet me të: të zhvendoset, të vendoset nëntokë apo të ngritet mbi shtylla lart apo të bëhet një zgjidhje në nivelin ekzistues-këto janë pyetjet dhe enigmat kërkojnë zgjidhje.

KK i Ferizajit së bashku me UN-HABITAT-in/Programin për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal shpallën konkursin ndërkombëtar për zgjidhjen ideore të qendrës së mobilitetit. Si rezultat i kësaj u pranuan 43 propozime nga 21 shtete.

Një detyrë projektuese ku kërkohet zgjidhje ideore që ofron idetë më të mira të mundshme për zgjidhjen e problemeve të lëvizshmërisë në pjesën kryesore të qytetit të dominuar nga hekurudha, treni dhe stacioni i autobusëve, taksitë dhe këmbësorët, ishte sfiduese për të gjithë konkurentët duke pasur parashysh edhe çështjen e integritit të dy pjesëve të qytetit të ndarë nga hekurudha.

Unë pata rastin të jem anëtar i Jurisë Profesionale, të udhëhequr në fillim nga profesori i nderuar Bashkim Fehmiu, vdekja e papritur e të cilit para përfundimit të punës së Jurisë Profesionale ishte një shokim i madh për të gjithë ne, një Jurie e cila ishte e përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme duke përfshirë arkitektë, urbanist, inxhinier të mekanikës dhe ndërtimtarisë, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit, sociolog e filozof si dhe ekolog.

Ky grup ekspertësh punoi në mënyrë intensive për katër ditë me rradhë në vlerësimin e të gjitha punimeve duke u bazuar në kriteret e caktuara me detyrën projektuese të konkursit. Gjatë punës kemi hasur në koncepte nga më të ndryshmet si për nga qasje ashtu edhe në prezentimin

e tyre grafik; ide që shkojnë nga propozimet e përkohshme me pak investime (sikur që ishte njëra me ndërtimin e vetëm një pyrgu sinjalizues) deri të propozimet e detajuara të cilat në mënyrë të sukseshme mundësojnë një integrim dhe funksionim të mirëfilltë të lëvizshmërisë në qytet. Zhvendosja e stacionit hekurudhor për malëra në pjesët periferike të qytetit është një element i përbashkët i të gjitha propozimeve të pranuar.

Në përgjithësi, shumica e propozimeve kanë dhënë idenë e konceptit të integruar të mobilitetit, duke vendosur në një vend stacionin e autobusëve dhe trenit, taksive, bicikletave dhe duke krijuar kështu një qendër mobiliteti, e cila do t'ua ofrojë mundësinë qytetarëve për shfrytëzimin më të lehtë të mënyrave të ndryshme të transportit.

Shfrytëzoj rastin për të falenderuar gjithashtu edhe sekretarinë e Jurisë Profesionale e përbërë nga stafi profesional i UN-HABITAT-it dhe Komunes së Ferizajit, e cila ishte krijuar nën rekomandimin e profesorit të ndjerë, të cilët bënë më të mirën për t'ia lehtësuar punën Jurisë.

Gazmend Vranovci

Anëtar i Jurisë Profesionale nga Ferizaj

Fituesit e konkursit

Më 19 Maj 2008, Komiteti Përzgjedhës ka shpallur fituesit e Konkursit Ndërkombëtar të Disajnit Hapësinor për Zgjidhjen Ideore të Qendrës së Mobilitetit në Ferizaj.

Duke punuar në listën e shkurtë të rekomanduar nga Juria Profesionale, Komiteti Përzgjedhës në mënyrë unanime ka vendosur të shpërblejë këta konkurrues:


Çmimi i parë i është ndarë kompanisë së



Fituesi i Çmimit të Parë



Fituesi i Çmimit të Dytë



Fituesi i Çmimit të Tretë

dizajnit SEARLE/WALDRON nga Melbourne/Australi;

Çmimii dytë i është ndarë Anna Klara Lundberg nga Malmo/Suedi dhe

Çmimi i tretë i është ndarë XL Arkitektët nga Prishtina/Kosovë.

Çmimi special i merituar është ndarë për Tower 151 Architects nga Zagrebi/Kroaci.

Ceremonia e shpërblimeve do të mbahet së shpejti.

NDRIÇIM I RRUGËVE PËR FEMRAT, SIPËRFAQE MË TË MIRA PËR MASHKUJT

Rolet e ndryshme që mashkujt dhe femrat i luajnë në shoqëri ndikojnë shumë në atë se si mashkujt dhe femrat, djemtë dhe vajzat, e perceptojnë ambientin e tyre të jetesës dhe se ku i vendosin prioritetet e tyre në lidhje me projektet e zhvillimit. Me qëllim të planifikimit të qyteteve të cilat i përgjigjen këtyre nevojave dhe pritjeve, planerët urban duhet të mësojnë se cilat janë pasojat sociale të vendimeve të tyre hapësinore.

Si pjesë e një qasjeje të ndjeshme gjinore ndaj planifikimit dhe menaxhimit urban, ekipi i Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal ka kryer një seri të punëtorive për çështjet gjinore në sferën e planifikimit në të gjitha komunat e Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal dhe për partnerët tjerë. Palët e ndryshme të interesit, dukë përfshirë edhe përfaqësuesit e

Kuvendeve Komunale, planerët urban, OJQ-të dhe mediat, kanë diskutuar çështjen dhe kanë shkëmbyer përvojat dhe pikëpamjet e tyre në atë se si janë reflektuar nevojat dhe aspiratat e mashkujve dhe femrave, djemve dhe vajzave në planifikimin e zhvillimit lokal. Trajnimi ka pasur për qëllim kuptimin e rëndësisë së pjesëmarrjes së barabartë të mashkujve dhe femrave në të gjitha sferat e planifikimit.

Gjatë këtij trajnimit, mashkujt dhe femrat kanë shprehur nevojat dhe prioritetet e tyre, nganjëherë thelbësisht të ndryshme, e nganjëherë komplementare apo të shprehura në mënyra të ndryshme. Disa rekomandime të dhëna nga femrat janë shumë specifike, si p.sh. çështja e strehimit për gratë mbajtëse të familjes, është ngritur nga gratë, gati

nga të gjitha komunat. Çështje tjetër me rëndësi kanë qenë vendet e reja të punës dhe mundësitë për gjenerim të të ardhurave, prodhimit në ferma, artet dhe zejet, si dhe një ambient i sigurt për femrat dhe fëmijët. Mashkujt më shumë kanë potencuar projektet infrastrukturore, siç janë rrugët, dhe përmirësimi i deponive dhe i ambientit. Rëndësia e edukimit dhe shërbimeve shëndetësore është ngitur nga të dy palët.

Trajnimi si i tillë është vlerësuar i suksesshëm dhe si një pikë kyçe për një kontribut të drejtë dhe të barabartë të dy palëve, mashkujve dhe femrave, për zhvillimin e komunave të Kosovës.

Rudina Qerimi
MuSPP/UN-HABITAT

PLANERËT HAPËSINOR TË KOSOVËS I MARRIN CERTIFIKATAT

Planerët hapësinorë, stafi aktual dhe i mëparshëm i Institutit Kosovar për Planifikim Hapësinor i morën certifikatat mbi kryerjen e suksesshme të Trajnimit në Planifikim Hapësinor dhe Zhvillimor të Kosovës në një solemnitet të organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) më 7 Mars 2008. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e UN-HABITAT-it në Kosovë dhe Institutit për Studime të Banimit dhe Zhvillimit Urban (IHS) me seli në Rotterdam, Holandë, si dhe të organizatave që e kanë përkrahur krijimin e Institutit Kosovar të Planifikimit Hapësinor dhe programin për ndërtimin e kapaciteteve të stafit të saj.

Me anë të një marrëveshjeje bashkëpunimi me Institutin për Studime të Banimit dhe Zhvillimit Urban, ekspertët e UN-HABITAT-it dhe IHS-it për katër vite me radhë i kanë ofruar përkrahje dhe këshilla profesionale Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kjo ka kontribuar në zhvillimin e sektorit të planifikimit hapësinor në përgjithësi dhe përgatitjen e draftit të Planit Hapësinor të Kosovës në veçanti. Kjo përkrahje është ofruar nëpërmjet një kombinimi të punëtorive, trajnimeve, përkrahjes në vendin e punës dhe këshillave të ekspertëve. Procesi i pregaditjes së draftit të Planit Hapësinor të Kosovës ka qenë rezultat i programit të ndërtimit të kapaciteteve të bazuar në qasjen e të mësuarit duke punuar dhe ka synuar zbatimin e teorisë në praktikë. "Përfundimi i suksesshem i këtij trajnimit nuk shënon fundin e të mësuarit të procesit të



planifikimit; njohuritë mbi procesin e planifikimit janë të pafundme", tha z. Luan Nushi, drejtor i Institutit për Planifikim Hapësinor në Kosovë.

Në emër të UN-HABITAT-it, Krystyna Galezia përgëzoi planerët hapësinor për përfundimin e suksesshëm të trajnimit duke shprehur që njohuritë e arritura do t'i kontibuojnë zhvillimit të ardhshëm të qëndrueshëm të

Forbes Davidson, menaxher i projektit dhe ligjërues i lartë në IHS, përgëzoi Ministrinë për entuziazmin e saj të madh për bashkëpunimin me IHS-in dhe UN-HABITAT-in si dhe për përkrahjen që i ka bërë procesit të trajnimit.

"Strategjia e ndërtimit të kapaciteteve e lidhur me prioritetet brenda MMPH është e rëndësishme, por theksi duhet vënë edhe në

6+3=10

PUNËTORITË E VIZIONIMIT NË 6+3 KOMUNA

Punëtoritë 5 ditore për caktimin e vizionit me përfshirjen e grupeve të ndryshme të palëve të interesit, kanë qenë një lloj shenje daluese për MuSPP1 dhe një mjet specifik në metodën e tij të planifikimit. Qëllimi kryesor i këtyre punëtorive ka qenë që të marrë mendimet e qytetarëve për planifikimin hapësinor afatgjatë dhe afatmesëm, si material për Planet e Zhvillimit Urban dhe Komunal dhe për zbatimin e tyre. MuSPP-i zhvilloi një 'format' të këtyre punëtorive që përfshinte aftësimin bazë për pjesëmarrësit në parimet e planifikimit, por e cila kryesisht fokusohet në "të mësuarit duke bërë".

Programi i punëtorisë përbëhej nga një numër i seancave, çdonjëra prej të cilave kishte objektiva të përcaktuara qartë dhe ishin krijuar modulet e trajnimit me rrjedhje logjike dhe fuqizim të ndërsjellë. Programi fillonte me një seancë për "thyerje akulli" duke treguar ndonjë ngjarje dhe duke përkujtuar hartën nostalgjike nga e kaluara e komunitetit, e cila pasohej nga analiza SWOT e çështjeve të përzgjedhura, siç janë, banimi, zhvillimi ekonomik, mbrojtja e mjedisit, etj., të cilat ndihmonin në diagnostifikimin e gjendjes së tanishme. Seanca e tretë fokusohet në transformimin e rezultateve të analizës në qëllime dhe objektiva dhe në formulimin e një deklaratë të vizionit për secilën prej çështjeve. Seanca e katërt dhe me sfiduesja ishte që ato objektiva të paraqiten në mënyrë vizuale në harta dhe skica. Detyra përfundimtare ishte integrimi i deklaratave të pjeshme ose tematike të vizionit në një deklaratë të përbashkët dhe kohësive të komunitetit dhe që të bëhen aranzhimet dhe zotimet themelore për aktivitetet vijuese.


Shumica e pjesëmarrësve përfaqësonin organizatat e shoqërisë civile, por ishin ftuar që të marrin pjesë edhe një numër i planerëve, vendimmarrësve dhe palëve të tjera përkatëse të interesit. Instituti i Planifikimit Hapësinor/ MMPH jo vetëm që ofroi

hartat dhe aftësimin themelor për Planin Hapësinor të Kosovës, por gjithashtu ndihmoi edhe grupet punuese që të zhvillojnë propozime të qëndrueshme të planifikimit. MuSPP-i kishte rolin që të ndihmojë procesin, të aftësojë pjesëmarrësit dhe të ndërmjetësojë në idetë kundërtëuese për të siguruar vazhdimin efikas dhe efektiv të procesit të planifikimit komunal. Të gjitha punëtoritë për përcaktimin e vizionit ishin organizuar si bashkëpunim i tre partnerëve: komunës, përfaqësuesëve të shoqërisë civile (shpesh përmes Këshillit joformal të shoqërisë civile-KJSHC dhe UN-HABITAT-it, (më vonë edhe CHWB [Trashëgimia kulturore pa kufij]), me një bashkëfinancim të dhënë nga fondacioni Friederich Ebert Stiftung.

Punëtoritë e parë ishte organizuar në Janar të 2007 me fokus në përmirësimin e kushteve jetësore në Mitrovicë, që kishte të bënte me tërë qytetin dhe që mbulonte zonat në të dy anët e lumit Ibër dhe prekte në mënyrë të njëjtë si shqiptarët ashtu edhe serbët e Kosovës... Përkundër shumë vështirësive dhe dy përpjekjeve të pasuksesshme për shkak të situatës politike, kjo punëtori e parë u dëshmuar të jetë shumë e suksesshme duke bërë bashkë përfaqësuesit e të dy komuniteteve dhe duke krijuar një forum për shkëmbimin e ideve. Ky proces po ashtu vuri themelet për diskutimin e problemeve të përbashkëta, aktiviteteve të planifikimit dhe për bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet veriut dhe jugut. Një vizitë e kohëve të fundit e një delegacioni të zyrës qendrore të Sida/UN-HABITAT në Mitrovicë konfirmoi se forcat shtytëse të shoqërisë civile dhe Komuna e Mitrovicës (jugore) ende mbështeten në vizionin e zhvilluar para 18 muajsh dhe për më tepër, në aktivitetet dhe raportet pas përcaktimit të vizionit. Punëtoritë e vizionit në Ferizaj, Gjilan, Gjakovë dhe Prizren ishin jashtëzakonisht të suksesshme

në nxjerrjen e ideve inovative dhe perspektive të zhvillimit të qëndrueshëm si kontribut për PZHK/ PZHU-të. Ato u pasuan nga një seri e ngjarjeve dhe raporteve si prezantimi publik i vizionimit, deklaratat e vizionimit nga shoqëria civile, dokumenti i integruar i vizionimit dhe rekomandimet për planifikim. Në rastin e Pejës, punëtoritë për caktimin e vizionimit u fokusua në një fushë specifike të komunës, e cila u identifikua si lokacion strategjik në PZHK/PZHU-të e aprovuara. Punëtoritë e vizionimit për të ashtuquajturën fushën EST (fushën e arsimit, sportit dhe turizmit) i bashkoi të gjitha palët me interes dhe rezultoi në një numër politikash dhe rekomandimesh për zbatimin e tyre si për komunën ashtu edhe për palët e tjera të interesit.

Pas angazhimit në punëtoritë e vizionimit në Prizren dhe Gjakovë, CHWB-ja në bashkëpunim me MuSPP/UN-HABITAT-in organizoi punëtorinë e vizionimit për pilot komunën e Junikut. Kjo punëtori ofroi një mundësi për angazhimin shumë aktiv si të autoriteteve komunale ashtu edhe të shoqërisë civile. Prezantimi dhe diskutimi publik ishte një ngjarje që do të mbahet mend, e mbajtur në një kullë të restauruar dhe e pasur me ushqim dhe muzikë vendore. Prezantimi ishte i kombinuar me një vizitë në terren në disa zona të veprimit të identifikuar në vizionin për zhvillimin e ardhshëm të kësaj komune të mrekullueshme kufitare, e cila i ka malet më të larta dhe ka numrin më të madh të kullave në Kosovë. Autoritetet e Junikut e morën rezultatin e kësaj punëtorie për vizionimin si strategji bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj pilot komune, duke caktuar kështu orientimin për të gjitha vendimet që do të merren në të ardhmen. Si rezultat i bashkëpunimit të tyre të suksesshëm, CHWB dhe MuSPP-ja organizuan edhe punëtorinë e vizionimit për dhe me pilot-komunën e Hanit të Elezit. (vazhdon në fq 9)



Sfida më e madhe në këtë rast ishte përpjekja për të gjetur një ekuilibër ndërmjet kushteve më të mira të jetës për komunitetin lokal dhe interesave ekonomike dhe kombëtare që lidhen me fabrikën e çimentos Sharrcem dhe me lokacionin e pikës së vendkalimit kufitar, që i japin Hanit të Elezit një karakter strategjik si portë hyrëse në Kosovë. Pjesëmarrja e Sharrcemit si palë kryesore me interes në procesin e planifikimit të zhvillimit lokal ishte një veçori e rëndësishme e kësaj punëtorie që shpinte në kultivimin e marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve lokale, sektorit të industrisë dhe shoqërisë civile. Por, siç theksoi shefi ekzekutiv i Sharrcemit në prezantimin e vizionit, kjo do të dëshmohej "kur të zbatohet në praktikë", pasi që ëndërrimi i një mjedisi më të mirë është më i lehtë se realizimi i tij në praktikë.

Në kohën e shkrimit të këtij raporti ne jemi në fazën përfundimtare të punëtorisë për vizionimin e Mamushës, pilot komuna e tretë me radhë. Mamusha ka qenë pjesë e komunës së Prizrenit por për shkak të procesit të decentralizimit në Kosovë, ky fshat rural me një komunitet të madh turk ka gjasa që të bëhet një komunë e re. Kjo nënkupton se ajo do të

jetë e obliguar që të hartojë PZHK-në (qoftë PZHK-në e plotë ose vetëm PZHU-në, pasi që PZHK-ja e Prizrenit tashmë e ka vizionin për Mamushën, i cili duhet të përcaktohet). Përmes përfshirjes jo vetëm të qytetarëve të Mamushës, por edhe të Prizrenit në punëtorinë për vizionimin, mund të zhvillohet një dialog për një zhvillim të integruar të këtyre dy komunave. Rasti i Mamushës është po ashtu specifik, pasi që ai përfshinë pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë dhe aktive të këshilltarëve politikë të ministrit të MMPH-së, i cili përfaqëson komunitetin turk në qeverinë e tanishme të Kosovës. Së shpejti ky vizionim do të prezantohet para qytetarëve dhe pilot komuna do të mund të përpunojë planin e saj zhvillimor duke u bazuar në këtë vizionim.

Mbetet të shpresohet dhe të pritët se do të ketë edhe punëtori të tjera për caktimin e vizionimit, të mëdha dhe të vogla, për veprime afatgjate dhe të menjëhershme. Por ndoshta tani është koha që të shikohet prapa para se të vazhdohet të ecet përpara ose para "se të fluturohet me autopilot". Qëllimi është që (pas verës) të organizohet një punëtori për "të menduar/ shqyrtuar" 6+3 punëtoritë e kaluara për vizionin, për dhe me pjesëmar-

rjen e të gjithë atyre që kanë qenë të përfshirë në punëtoritë e mëhershme – sigurisht mbi 300 persona – dhe për institucionet përkatëse institucionale të cilat mund dhe duhet të shfrytëzojnë përparësitë e kësaj metode, të aplikojnë këtë metodë dhe ta përshtatin atë për nevojat e tyre. Natyrisht ne do të theksojmë të arriturat pozitive madje do të lavdërojmë frymën e krijimit të përbashkët dhe kujtimet e paharrueshme nga punëtoritë për vizionin. Megjithatë, ne do të jemi edhe vetëkritik dhe do të shikojmë të gjejmë mënyrat e përmirësimit të metodës dhe mjeteve kudo dhe kurdo që është e mundur.

Vetëm duke bërë këtë ne mund të vlerësojmë përvojat e deritanishme 6+3 dhe t'ia arrijmë t'i bëjmë ...10. Tashmë u është kërkuar të gjithë pjesëmarrësve që të mendojnë për këtë dhe të na informojnë për përvojat e tyre të mira dhe për ato jo aq të mira, jo vetëm për punëtoritë e vizionit, por edhe në lidhje me hapat e mëpastajmë dhe ndikimin e tyre në procesin dhe vendimet për planifikimin komunal.

Frank D'hondt and Arijeta Himaduna,

MuSPP/UN-HABITAT

SFIDAT TERRITORIALE DHE BASHKËPUNIMI NË EVROPËN MË TË GJERË

Seminari i ESPON-it mbi Sfidat Territoriale dhe Bashkëpunimin në Evropën e Zgjeruar ka mbledhur më shumë se njëqind përfaqësues nga shtetet evropiane, përgjegjës për monitorimin e zhvillimeve hapësinore, duke përfshirë përpiluesit e politikave, vendimarrësit, praktikantët e BE-së, niveli nacional, regjional dhe lokal si dhe shkencëtarët, për të diskutuar dhe shkëmbyer njohuritë mbi dinamikën e zhvillimeve territoriale ashtu edhe zhvillimin territorial të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të BE-së dhe shteteve fqinje të saj.

Seminari i mbajtur gjatë kryesisë slovene të BE-së, është mbajtur më 1-2 qershor 2008 në Portorozh, në prezencë të Mitja Bricelj, sekretarit shtetëror në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Marko Starman, sekretarit shtetëror në Zyren e Qeverisë për Vetëqeverisjen Lokale dhe Politikën Regjionale të Republikës së Slovenisë. Për dallim nga seminarët e mëhershme, në këtë seminar **për herë të parë kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e regjionit të Ballkanit dukë përfshirë Kroacinë, Serbinë, Malin e Zi dhe Kosovën.**

Në këtë seminar ishte rasti për të mësuar më shumë mbi rezultatet e ESPON 2006 dhe projektet e saj, që kanë krijuar një bazë të mirë për programin e ri ESPON 2013.

Z. Peter Mehlbuy, drejtor i Njësisë Koordinuese të ESPON-it, në prezantimin e tij tha: *"ESPON-i do të vazhdojë të monitorojë zhvillimin hapësinor me anë të veglave themelore të sistemit të vazhdueshëm të monitorimit, ndërlihdjen e shënimeve, analizën hulumtuese dhe bashkëpunim më të ngushtë me programet tjera. Shkëmbimi i përvojave mbi dinamikën territoriale, skenaret dhe efektet e politikave, mund të ndihmojnë në krijimin e një kuptimi të ndërsjellë të përfitimeve të zhvillimit, integritetit dhe bashkëpunimit brenda një Evrope të zgjeruar dhe në të njëjtën kohë përkrahja për shfrytëzimin e evidencave brenda një shkalle evropiane në formëzimin e politikave praktike".*

Një fakt i dukshëm i hulumtimit dhe rezultateve të ESPON-it është që zhvillimet jo të baraspeshuara territoriale, ndryshimet klimatike, globalizimi i përsheptuar, migrimi, çmimet e rritura të energjisë, do të vazhdojnë të jenë sfida për zhvillimet territoriale në BE dhe kjo do të ndikojë në baraspeshën dhe kohezionin mes pjesëve të ndryshme të Evropës. *"Ne duhet të pranojmë që hapësira është një aset"*, tha z. Philippe Montfort nga Komisioni Evropian, duke përkrahur idenë që gjatë trajtimit të sfidave aktuale të kemi një qasje të integruar me kohezion territorial si instrument qendror për zbatimi

min e Traktatit të Lisbonit dhe për konsiderimin e specifikave të territorit të Bashkësisë Evropiane.

Ky seminar ka qenë njëkohësisht edhe kreativ në dhënien e ideve dhe vizioneve të reja për zhvillimet territoriale brenda kontekstit evropian dhe botëror; ka ofruar një platformë të mirë për diskutimin e rasteve interesante dhe për shkëmbimin e përvojave në bashkëpunimin ndërkombëtarë dhe ndërkufitar, duke përfshirë përvojat nacionale të politikave dhe strategjive hapësinore nga shtete të ndryshme brenda dhe jashtë BE-së.

Rëndësia e veçantë e këtij seminarit për Kosovën konsiston në mundësinë për të takuar dhe krijuar kontakte të reja, kërkimin e bashkëveprimeve në rrjetëzim si dhe përfaqësimin e Kosovës në programin e ESPON-it 2013. Një nga objektivat e programit të ESPON-it 2013 është edhe rritja e mundshme e zonës së mbulimit, me prioritet të dhënë përfshirjes së shteteve kandidatë të BE-së dhe Ballkanit perëndimor si një rregull i përgjithshëm. **Në një të ardhme të afërt institucionet e Kosovës duhet të ndjekin iniciativat e tilla.**

Lumnije Gashi,

*Pjesëmarrëse në seminarin e ESPON-it
MuSPP/UN-HABITAT*

(vazhdon nga faqja 1)

Një element shumë i rëndësishëm dhe qenësor në MuSPP2 është zhvillimi i një "strategjie dalëse", e cila do të sigurojë që në fund të programit të bëhet një tranzicion i lehtë i roleve dhe aktiviteteve kryesore të MuSPP-it tek institucionet dhe organizatat kosovare. Për këtë qëllim duhet të intensifikohet dialogu dhe bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror, si me MMPH-në, MAPL-në dhe me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK). Një ndër zotimet e bëra në Selanik është që t'i ofrohen këshilla dhe

ndihmë Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor në AKK, i cili përfshinë shumicën e komunave të Kosovës. Një sfidë tjetër është edhe siguri që Departamenti dhe Instituti i Planifikimit Hapësinor të luajnë rol më vendimtar dhe më të qartë në strategjinë dalëse.

Dhe në fund, por jo më pak e rëndësishme: siç ishte rasti me MuSPP1, edhe suksesi i MuSPP2 do të varet në masë të madhe nga angazhimi dhe përkushtimi i shoqërisë civile dhe organizatave të bazuara në komu-

nitet (OBK) në komunat përfituese, gjatë gjithë procesit të planifikimit, duke filluar nga përcaktimi i vizioneve afatgjate deri te projektet dhe veprimet konkrete. Shpresojmë se këto organizata do të luajnë një rol më të madh në MuSPP 2

Garth Seneque,

KKT/ Shef i Misionit të UN-HABITAT-it në Kosovë

Frank D'hondt,

Koordinator i planifikimit hapësinor në MuSPP

Kutia 1: Thekse të veçanta nga MuSPP 1 2006 - 2008

Të arriturat si rezultat i përbashkët i MuSPP-it dhe partnerëve të tij janë:

- ⊗ 9 punëtori të vizionimit me dokumente të integruara të vizionimit/rekomandimet e ekspertëve për PZHK/PZHU
- ⊗ Aprovimi i PZHK/PZHU së Pejës dhe udhërrëfyesi i pregaditur për implementim
- ⊗ PZSHK/PZHU të Gjakovës, Gjilanit dhe Ferizajit në stadin final pas shqyrtimit publik
- ⊗ PZHK/PZHU e Mitrovicës më shumë se 'në gjysmë të rrugës'
- ⊗ Drafti i PZHK-së së Prizrenit mund të përgatitet duke u bazuar në udhëzimet e këshilltarit
- ⊗ Trupat e planifikimit janë instaluar apo riaktivizuar
- ⊗ Kapacitete të rritura të stafit dhe institucionit në qeveritë lokale dhe shoqëritë civile lokale
- ⊗ Vetëdije e rritur mbi mobilitetin e qëndrueshëm, vendbanimet joformale, çështjet gjinore, hapësirat publike, dizajnin urban
- ⊗ Planet vepruese për transportin jomotorik, transportin publik, ambientet e sigurta shkollore, zonat industriale, hapësirat e parqeve dhe ato publike, vendbanimet joformale, planet rregulluese
- ⊗ 6 projekte demonstruese të zbatuara apo në zbatim e sipër:
 - Mitrovicë: rrugët qarkore (jug) dhe rampat për këmbësorë (veri)
 - Pejë: Ridizajnimi i rrugës së stadionit të futbollit (hyrja e qytetit)
 - Gjakovë: përmirësimi i Parkut të qytetit
 - Prizren: Rrethoja e oborrit të shkollës për një mjedis të sigurt shkollor
 - Ferizaj: Konkursi i Zgjidhjes Ideore për Qendrën e Mobilitetit
 - Gjilan: Përmirësimi i varrezave qendrore të qytetit
- ⊗ Aktivitetet e zgjeruara të komunikimit:
 - Faqja e internetit www.unhabitat-kosovo.org
 - Buletinet 1-5

Fletushkat (për Vizionimin, Shqyrtimin Publik, Dizajnin Urban, Vendbanimet Joformale)

Mbulimi i mediave, debatet televizive

Pengesat në MuSPP1 dhe sfidat për MuSPP2 janë:

- ⊗ Kapacitetet lokale të planifikimit ende të pamjaftueshme
- Mungesa e njësive 'të vërteta' të planifikimit
- Mungesa e përshkrimit të punës apo mandateve të qarta të trupave tjerë të planifikimit (Ekipi Komunal i Planifikimit, Këshilli i Ekspertëve të Planifikimit)
- Mosnjohja e Këshillit Joformal të organizatave të shoqërisë civile
- ⊗ Baza e dobët e organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit
- ⊗ Përkushtim i dobët ndaj planifikimit nga ana e ish/kryetarëve të komunave
- ⊗ Mungesa e lidhjeve në mes të planifikimit dhe buxhetit
- ⊗ Ndërrim i shpeshtë i stafit lokal (të planifikimit)
- ⊗ Konteksti i disfavorshëm makro-institucional (statusi dhe zgjidhjet)
- ⊗ Bashkëpunimi i pamjaftueshëm mes nivelit qendror dhe lokal



Kutia 2: Çka dëshirojmë të bëjmë në MuSPP 2?

- ⊗ Të përkrahim komunën në përfundimin dhe aprovimin e planit të saj hapësinor, i cili duhet të adresojë nevojat për zhvillim dhe prioritetet e komunës.
- ⊗ T'i asistojmë komunës të shfrytëzojë procesin e planifikimit hapësinor për të identifikuar, dizajnuar dhe menagjuar zbatimin e projekteve kapitale prioritare.
- ⊗ T'i asistojmë komunës të përgatis dhe zbatojë instrumentet e planifikimit rregullues për të udhëhequr dhe kontrolluar zhvillimet të cilat janë identifikuar në PZHK/PZHU.
- ⊗ Të forcojmë kapacitetin e qeverisë së nivelit qendror në përkrahjen e procesit të planifikimit dhe zhvillimit komunal.

⊗ T'i asistojmë komunës në përgatitjen dhe implementimin e instrumenteve të planifikimit rregullativ për udhëheqjen dhe kontrollin e zhvillimeve, të identifikuar në planin hapësinor.



KËNDI I UN-HABITAT-IT

FORUMI URBAN BOTËROR

Tema: Urbanizimi i harmonizuar: Sfida e zhvillimit të ekuilibruar territorial

Forumi urban botëror (FUB) është themeluar nga Kombet e Bashkuara për të studiuar një nga çështjet më urgjente me të cilat ballafaqohet sot bota: urbanizimi i shpejtë dhe ndikimi i tij në komunitete, qytete, ekonomi dhe politika. Parashikohet që në pesëdhjetë vitet e ardhshme 2/3 e njerëzimit do të jetojnë në qytetet dhe qyteza. Sfidë kryesore para nesh do të jetë që të minimizohet varfëria që bulëzon në qytete, të përmirësohet qasja e njerëzve të varfër në zonat urbane në infrastrukturën kryesore si strehimi, uji i pastër dhe kushtet sanitare dhe që të arrihet një rritje dhe zhvillim i qëndrueshëm urban, që do të jetë jo i dëmshëm për mjedisin. FUB është një takim bienal i një numri të madh partnerësh nga organizatat joqeveritare, organizatat e bazuara në komunitete, profesionistë për çështje urbane, akademikë, qeveritarë, autoritete lokale dhe kombëtare dhe asociacione ndërkombëtare të pushteteve lokale. Ai u jep të gjithë këtyre akterëve një platformë të përbashkët për të diskutuar



problemet urbane në mënyrë formale dhe joformale dhe për propozuar veprime për krijimin e qyteteve të qëndrueshme. Seanca e katërt e Forumit Urban Botëror (FUB4) do të organizohet nga Qeveria e Kinës dhe do të mbahet në qytetin e vjetër Nanjing prej 03-07 Nëntor 2008. Forumi është i suksesshëm sepse dallon nga organet qeverisëse të OKB-së. Pasi që nuk është ligjvënës dhe nuk punon sipas rregullave formale të procedurës, me të cilat zakonisht mbahen takimet zyrtare të

OKB-së, aranzhimet e punës së Forumit qëllimisht janë të thjeshta dhe relativisht joformale për të pasur një debat të shëndoshë dhe gjithëpërfshirës për problemet urbane. Pjesëmarrja është shumë e hapur dhe mundëson një dialog efektiv ndërmjet të gjithë akterëve që punojnë në çështjet urbane. Qyteti i Nanjing-ut dhe UN-HABITAT-i iu dëshirojnë mirëseardhje në sesionin e katërt të Forumit Urban Botëror!

Burimi: www.unhabitat.org

KËNDI I MEDIAVE

Në këndin e Mediave kemi zgjedhur disa tituj e citime interesante në lidhje me planifikimin urban dhe zhvillimet në Kosovë. Artikujt origjinalë mund t'iu dërgohen sipas kërkesës

GJILAN

Gjilani, Kumanova dhe Presheva për "relativizim" të kufinjve

Në artikullin e gazetës ditore Koha Ditore është dhënë një artikull interesant mbi bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërregjional. Artikulli përfshinë edhe idetë e reja, që kryetarët e tri komunave kufitare kanë diskutuar mbi relativizimin e vijave kufitare shtetërore, nevojën për bashkëpunim veçanërisht në fushën e arsimit, komunikacionit, tregtisë etj. Ka qenë një marrëveshje e përbashkët e kryetarëve e komunave mbi bashkëpunimin e ndërsjellë, pa përfshirjen e domosdoshme të autoriteteteve nga Brukseli, Gjeneva dhe qendrave tjera ndërkombëtare.

Burimi: Koha Ditore, 12 Prill 2008

GJAKOVA

Mbrojtja e hapësirave publike

Artikulli në Lajm shkruan mbi projektin e përbashkët ndërmjet autoriteteteve komunale të Gjakovës dhe UN-HABITAT-it për përmirësimin e terrenit të parkut në qendrën e qytetit me ulëse të reja, ndriçim dhe kënde të lodrave për fëmijë etj. Propozimet e Jenny Donovan, eksperte e UN-HABITAT-it për dizajnin urban, përfshijnë edhe pasurimin e parkut me një kafeteri të re dhe ndërtimin e banjove publike për përmirësimin e karakterit rekreativ të parkut. Përfaqësuesi i Drejtoratit të Shërbimeve Publike, z. Pjetër Frrokaj, sqaroi se mungesa e hapësirave të gjelbëra publike brenda qytetit paraqet një indikator për më shumë investime në këtë fushë në të ardhmen.

Burimi: Lajm, 12 Mars 2008

PRIZREN

Stop kaosit urban

Artikulli në gazetën ditore Lajm ofron informatën mbi zotimin e drejtorit të ri të Urbanizimit dhe Inspeksionit në Prizren për zgjidhjen e problemeve të ndërtimeve pa leje. "Për të ndaluar këtë fenomen negativ duhet të bashkëpunojmë më afër me profesionistë dhe duhet të kemi një tjetër qasje në pregatitjen e planeve urbanistike" tha Çelë Lamaj, drejtor i Urbanizimit në Prizren. Sipas tij, pergatitja e planeve rregulluese urbane është e rëndësishme më të madhe për ndaljen e kaosit urban. Përveç kësaj, komuna do të fillojë të legalizojë ndërtimet që nuk bien ndesh me planet urbane.

Burimi: Lajm, 4 Shkurt 2008

MITROVICA

Mitrovica shihet si një qytet kompakt

Artikulli ofron informatën për punëtorinë e vizionimit të organizuar nga ekipi i planifikimit komunal dhe "Lin Projekt", të cilët së bashku me kompanitë Metron dhe Abi Group nga Zvicra ka përgatitur Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban. Plani parasheh Mitrovicën si qytet kompakt, multietnik dhe qendër edukimi. Plani i jep theks të veçantë prioritetëve, sikur janë zhvillimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore, zhvillimi i fermave, zonave rekreative, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, etj. Sektori ekonomik është përmendur si një mundësi për bashkëpunim më të afërt në mes të dy komuniteteve.

Burimi: Koha Ditore, 7 Shkurt 2008

PEJA

Berisha bëhet ciklist, e konsideron Pejën të gatshme për Evropë

Në gazetën ditore 'Koha Ditore' është raportuar për garën e ciklistëve me rastin e Ditës së Evropës, të organizuar nga Kuvendi Komunal i Pejës, UN-HABITAT-i dhe Bashkimi Evropian dhe i cili mblodhi ciklistët nga komuna e Pejës, Istogut dhe Klinës. Kryetari i Komunës, z. Berisha bashkë me z. Çeku, deputet në Kuvendin e Kosovës, u dukën si dy sportistë të vërtetë. "Kjo ngjarje tregon edhe një herë se Kosova është e gatshme për rrugën e saj drejt Evropës", tha z. Berisha, derisa priste që tua dorëzojë shpërblyemet tre fituesve të kësaj gare ciklistike.


Burimi: Koha Ditore, 4 Maj 2008

FERIZAJ

Ferizaji atraktiv për arkitektë nga pesë kontinente

Artikulli ofron informatën mbi konkursin ndërkombëtar për projektin ideor të Qendrës së Mobilitetit në komunën e Ferizajit – projekt i përbashkët në mes komunës së Ferizajit dhe UN-HABITAT-it, "43 punimet nga kompani të ndryshme të dizajnit nga e gjithë bota, me ide të reja dhe atraktive, kanë qenë befasi për qytetarët e Ferizajit" tha Mustafë Zariqi, planer që punon për Drejtoratin e Urbanizimit në Ferizaj.

Burimi: Koha Ditore, 1 Prill 2008



Ftesë për të kremtuar Ditën Botërore të Habitatit 2008

Kombet e Bashkuara kanë emërtuar të hënën e parë të tetorit të çdo viti si Ditë Botërore të Habitatit. Ideja është që të pasqyrohet gjendja e qyteteve tona dhe e drejta themelore për strehim adekuat për të gjithë. Gjithashtu synohet që bota të përkujtohet për përgjegjësinë e saj kolektive për të ardhmen e habitatit njerëzor. Kombet e Bashkuara kanë zgjedhur temën e Qyteteve të Harmonishme për vitin 2008 me qëllim të ngritjes së vetëdijes mbi problemet e urbanizimit të shpejtë, efektin e saj në ambient, rritjen e lagjeve të këqija, dhe urbanizimin e varfërisë pasi që shumë e më shumë njerëz zhvendosen në qytete duke kërkuar jetë më të mirë. Këtë vit UNHABITAT-i do të fokusohet në qasjen e barabartë në burime dhe raste si kuptim i arritjes së harmonisë në qytete.

Në të vërtetë, aq është rëndësia e të gjitha këtyre aspekteve të Qyteteve të Harmonishme sa që raporti kryesor i UN-HABITAT-it në vitin 2008 si dhe sesioni i katërt e Forumit Urban Botëror në Nanjing, Kinë prej datës 3-7 Nëntor, gjithashtu do të fokusohen në Qytetet e Harmonishme me qëllim të përfundimit të mesazhit të Ditës Botërore të Habitatit.

Qytetet e Harmonishme janë qytete përfshirëse, ku secili dhe secila kulturë ka shtëpinë.

Idetë e juaja janë më se të mirëseardhura për kremtimin e Ditës Botërore të Habitatit në Kosovë.

BASHKË BËJMË QYTETE MË TË MIRA

Për të siguruar një jetë më të mirë për gjithë qytetarët, Kosova ka nevojë për qytete më të mira. Kjo mund të arrihet vetëm përmes planifikimit dhe punës së përbashkët. "Bashkë krijojmë qytete më të mira" është motoja e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal, financuar nga SIDA, përmes të cilit UN-HABITAT-i do të mbështesë planifikimin komunal hapësinor në Kosovë. Planet duhet të jenë strategjike dhe të orientuara në veprime, detaje në planet rregullative urbane dhe të zbatuara me investime private e publike. Gjashtë qytetet sekondare të Kosovës – Peja, Gjakova, Prizreni, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjilani – mund të kontribuojnë në një zhvillim më të drejtpeshuar të Kosovës dhe të zvogëlojnë migrimet e vazhdueshme të popullsisë drejt kryeqytetit, Prishtinës. Përmes integritimit në rrjetin urban evropian, qytetet dhe qytetarët e Kosovës do të lidhen me qytete tjera evropiane. Kjo mund të arrihet duke tërhequr investimet në zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe duke përmirësuar qasjen për të gjithë. Investimet private janë të nevojshme për t'u kombinuar me ato publike, drejt sigurimit të shërbimeve më të mira për qytetarët: banim të përshtatshëm social, spitale, shkolla, transport publik, rrugë, si dhe përfundimisht, por jo më pak e rëndësishme, hapësirat atraktive publike për t'i kënaqur nevojat e një shoqërie në ndryshim.

IMPRESSUM



Udhëheqës i Zyrës
Garth Seneque
office@unhabitat-kosovo.org

Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë

Zyra:
UN-HABITAT Kosovë
Nazim Gafurri Nr. 33,
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381/38/517835
Fax: +381/38/517836

Për më shumë informata:
www.unhabitat-kosovo.org
Kontakt:
info@unhabitat-kosovo.org

Redaktorë: **Lumnije Gashi**, Zyrtare për Informim dhe Komunikim; **Krystyna Galezia**, Koordinatorë për Shoqëri Civile, Çështje Gjinore dhe Ngritje të Kapaciteteve; **Frank D'hondt**, Koordinator i Planifikimit Hapësinor në MuSPP; **Kieran Quigley**, Vullnetar i MuSPP-it; Dizajni dhe Faqesja: **Astron Mahmutaj**, Asistent për Informim dhe Komunikim

Ky Buletin është mundësuar nga Qeveria e Suedisë përmes SIDA-s. Gjitha vështrimet, mendimet dhe konkludimet i përkasin autorëve. Artikujt pa emër autori janë pjesë e ekipit të MuSPP-it. Kontributet në lidhje me komunat jo domosdoshmërisht reflektojnë pozitën dhe vendimet e komunave në fjalë. Përmbajtja e këtyre artikujve jo domosdoshmërisht reflektojnë qëndrimin e UN-HABITAT-it ndaj çështjeve të ngritura apo deklarata të bëra, si dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë vështrimet e SIDA-s, apo Qeverisë së Suedisë.